

Politikë
Siguri
Kulturë
Ndërkombëtare
Shëndetësi
Opinion
Teknologji
Sport
Shpallje të vogla
Kalendari
Informata

Shpallje / Publikime


**MINISTRIA E
EKONOMISË DHE
FINANCAVE**

05.10.2010 Njoftim
për furnizim Ri-

tender: Furnizim me pajisje të
IT-së- Serverë [Lexo](#)


**MINISTRIA E
EKONOMISË DHE
FINANCAVE**

28.09.2010 Vendim:
Autorizimin (licencimin) e
operatorëve ekonomik për
shitjen, instalimin dhe
mirëmbajtjen e pajisjeve
elektronike fiskale për: Printec"
L.L.C.... [Lexo](#)


**MINISTRIA E
EKONOMISË DHE
FINANCAVE**

22.09.2010 Ministria e
Ekonomisë dhe Financave shpallë
konkurs për Drejtor i
Përgjithshëm i Njësisë së
Inteligjencës Financiare
[Lexo](#)

POLITIKË



Zgjedhjet e
jashtëzakonshme
mbahen më 12
dhjetor

SIGURI



Arrestohen katër
persona për
falsifikim

SHËNDETËSI



Përfitimet e
aspirinës mund të
jenë edhe më të
mëdha

USAID ndihmon të rinjtë të gjejnë punësim profesional


Pristinë, 2 nëntor - Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

Mark Wood, Drejtor i KPEP-it ka theksuar se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës.

Pasi që e gjithë ekonomia e Kosovës sipas tij po lëviz drejt shekullit 21, konkurrenca në treg, zhvillimi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të reja, do të jetë kërkesë thelbësore.

"Për t'u ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës" tha Wood.

- Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

- Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service - Austria (WUS - Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent.

- Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestarë dhe 5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar, si dhe

- Programi i praktikës për industrinë e përpunimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK), i angazhoi 16 studentë nga Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe nga Shkolla Profesionale dhe të Zdrukthëtarisë dhe Qendra për Aftësim Profesional, të gjithë klientë të KPEP-it.

Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për shkak se 16 studentëve u është ofruar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. Deri më sot, 14 prej tyre i kanë pranuar ofertat për punë.

Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë i USAID-it është një nismë katër vjeçare e filluar në tetor 2008 dhe synon stimulimin e aftësisë konkurruese të sektorit privat në ekonominë e Kosovës.

Komente:

rita
sukseses

Komente:

Emri:

E-mail:

Komenti:

Dërgo

Prapa



Tërmet në Serbi, 2 të vdekur

Kina ka shtuar investimet reale në vendet e tjera

Banka amerikane pritet të hedhë në treg qindra miliardë dollarë

Shqipëria, top destinacion turistik për vitin 2011

BB zvogëloi parashikimin për rritjen ekonomike të Rusisë

Google lëshon pamjet e para Street View në Gjermani

Lotus me konceptin City Car

FMN:Krizë ekonomike, 20 milionë të papunë në botë

Përfitimet e aspirinës mund të jenë edhe më të mëdha

Emma Watson, milionere pa e ditur

Kim Kardashian thyen gishtin e këmbës

Xavi: Messi është më i mirë se sa Maradona

Ronaldo: S'ka kush që mund të më mposhtë

Xavi mund të lërë kombëtaren spanjolle

Zgjedhjet e jashtëzakonshme mbahen më 12 dhjetor

Rrezohet qeveria Thaçi

Ekonomi

BB zvogëloi parashikimin për rritjen ekonomike të Rusisë



Moskë, 3 nëntor - Banka Botërore (BB) lajmëroi se është zvogëluar parashikimi për rritjen e ekonomisë ruse

për shtet...

Lajme tjera nga Ekonomia

FMN:Krizë ekonomike, 20 milionë të papunë në botë

USAID ndihmon të rinjtë të gjejnë punësim profesional

Ndërkombëtare

Tërmet në Serbi, 2 të vdekur

Beograd, 3 nëntor - Një lëkundje e fortë tërmeti është regjistruar në Serbinë Qëndore. Sizmiologët kanë...

Lajmet tjera Ndërkombëtare

Rexhep Tajip Erdoan, vizitë dy ditore në Kosovë

Kina fillon numërimin më të madh të popullsisë në botë